



KOMISIONI RREGULLATOR
I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË
UJIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT



NJOFTIM PËR OPINIONIN

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit mori vendim, me të cilin bëhet **rritja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht për 0,26 %** në raport me vendimin e datës 26.04.2021.

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës **EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98 nuk ndryshojnë**, respektivisht mbeten në të njëjtin nivel siç janë përcaktuar me vendimin për ndryshimin e vendimit të përcaktimit të çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit nga data 26.04.2021.

Çmimet e shitjes me pakicë të **EURODIZELIT (D-E V) dhe të Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1) rriten për 0,50 denarë/litër.**

Çmimi i shitjes me pakicë i **Mazutit M-1 SU ulet për 0,149 den/kg dhe do të jetë 34,443 den/kg.**

Nga data 5.5.2021, ora 00:01 çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:

Benzinë për motorë	EUROSUPER BS - 95	67,00 (denarë/litër)
Benzinë për motorë	EUROSUPER BS -98	69,00 (denarë/litër)
Naftë për motorë	EURODIZEL BS (D-E V)	59,00 (denarë/litër)
Vaj për Djegie	Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)	58,50 (denarë/litër)
Mazut M-1 SU		34,443 (denarë/kilogram)

Në periudhën e kaluar shtatëditore të gjitha **çmimet referente në bursat botërore**, mesatarisht shënojnë rritje edhe atë: te benzina për 1,243 %, te nafta për 2,111 %, te vaji ekstra i lehtë për 1,287 % dhe të mazuti për 0,048% .

Në të njëjtën periudhë **kursi i denarit në raport me dollarin është më i ulët për 0,524%.**

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 5.5.2021. Tregtarët me shumicë dhe pakicë me derivate të naftës dhe lëndë djegëse për transport, mund t'i formulojnë çmimet e derivateve të ndryshme të naftës dhe lëndëve djegëse për transport edhe më të ulëta se çmimet më të larta që janë përcaktuar.

Çmimet e shitjes me pakicë të **EURODIZELIT dhe EUROSUPER BS – 95** në Maqedoninë e Veriut dhe disa vende të BE-së (https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin_en datë 26.4.2021), janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 1. Çmimet e shitjes me pakicë të Eurodizelit dhe të Eurosuperit BS-95 (çmimet në vendet e UE-së janë nga data 26 prill 2021)

	Eurodizel (EUR)	EUROSUPER BS-95 (EUR)
Maqedonia e Veriut	0,958	1,088
Austria	1,170	1,218
Bullgaria	1,081	1,081
Kroacia	1,295	1,371
Gjermania	1,310	1,522
Greqia	1,317	1,600
Italia	1,438	1,577
Hungaria	1,160	1,169
Sllovenia	1,190	1,172

4.5.2021